



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 5781 prot.

Himarë, më 07.10.2024

## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR DREJTUES TË POLICISË BASHKIAKE, NË DREJTORINË E POLICISË BASHKIAKE**

Në zbatim të ligjit nr. 89/2022, “Për policinë bashkiake”, vendimit nr. 452, datë 26.07.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullorës kuadër të policisë bashkiake”, si dhe vendimit nr. 13, datë 27.02.2024 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Himarë për vitin 2024”, si dhe vendimit nr. 40, datë 12.04.2024 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, “Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e Bashkisë Himarë për vitin 2024”, drejtorja e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, njofton shpalljen për:

**1 (një) vend të lirë pune në pozicionin: drejtues i policisë bashkiake – në drejtorinë e policisë bashkiake**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve është deri më datën: 15.11.2024**

### **Kompetencat dhe detyrat e drejtuesit të policisë bashkiake**

1. Drejtuesi i policisë bashkiake ka këto kompetenca dhe detyra, në përputhje edhe me aktet e tjera rregullatore:
  - a) organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për sigurimin e zbatimit të detyrimeve dhe kompetencave që ka policia bashkiake;
  - b) koordinon veprimtarinë e punës me Policinë e Shtetit për zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e rendit e të sigurisë publike në parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme për aktivitetet që zhvillohen në territorin e bashkisë;
  - c) planifikon aktivitetin në mbështetje të detyrave të caktuara për të siguruar realizimin në kohë të objektivave të përcaktuara;
  - ç) kryen analiza, raporte, përshkrime që lidhen me veprimtarinë e Policisë Bashkiake;

- d) i propozon kryetarit të bashkisë kalendarin e trajnimeve për të siguruar kualifikimin periodik profesional të punonjësve të policisë bashkiake;
- dh) këshillon kryetarin e bashkisë dhe jep mendime për zgjidhjen e çështjeve në fushën e përgjegjësisë së tij

### **Kriteret për pranimin e kandidateve në Policinë Bashkiake:**

Kandidati për pranimin në pozicionin drejtues i policicisë bashkiake duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

1. të jetë shtetas shqiptar;
2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
4. të ketë përfunduar arsimin e lartë
5. të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në administratën publike, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, në profesionet e lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;
6. të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
7. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
8. të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
9. të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;
10. të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

1. kërkesën;
2. jetëshkrimin;
3. fotokopjen e kartës së identitetit;
4. fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të mesëm të lartë;
5. 2 (dy) foto me përmasa 4 x 6 cm;
6. raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore;
7. certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
8. vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale;
9. vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykimi;
10. dokumentet për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës;
11. vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike;
12. vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

13. vërtetimin e besueshmërisë që lëshohet nga struktura vendore e Policisë së Shtetit, me kërkesën e bashkisë përkatëse, përpara pranimit në Policinë Bashkiake.
14. Formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 15.11.2024.***

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak nga komisioni i përzgjedhës, *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse* do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë Himarë dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimimit është 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

#### **Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:**

- Njohuritë mbi ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Njohuritë mbi vendimin nr.452, datë 26.07.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullorës kuadër të policisë bashkiake”;

#### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Kandidatët do të vlerësohen në këto faza të konkurimit:

- **Testim me shkrim deri në 60 pikë**

Testimi me shkrim kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga shpallja e listës së kandidatëve, që plotësojnë kriteret ligjore për t’u pranuar në policinë bashkiake. Rezultatet e testimit me shkrim dalin brenda ditës së testimit. Kandidati nuk kualifikohet për vazhdimin e konkurrimit nëse nuk merr 60% të pikëve të përcaktuara. Kandidati që merr më shumë 60% të pikëve të përcaktuara të testimit do të do të njoftohen me anë të postës elektronike për të vazhduar procesin e intervistes.

- **Intervista me gojë deri në 40 pikë**

Intervista konsiston në testimin e aftësitëve të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime. Në këtë fazë konkurrimi, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 40 (njëzet) pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) jetëshkrimi (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 10 pikë;
- b) intervista, deri në 30 pikë.

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim dhe rezultatit të intervistës me gojë. Kandidati që merr më shumë se 60 pikë për të dyja fazat konsiderohet i suksesshëm. Kandidatët, që kanë marrë më pak se 60 pikë, renditen në një listë të posaçme që nuk bëhet publike dhe ata njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore.

#### **Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit:**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për vlerësimin përfundimtar. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes dhe njoftimit të rezultateve të testimit.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

